



KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË
SKUPŠTINA OPŠTINE - SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA



PROCESVERBAL II/2023

I mbajtur me rastin e mbledhjes së II (dytë) të jashtëzakonshme për vitin 2023 të Kuvendit të Komunës së Suharekës

Vendi: Suharekë
Zyra: Salla e Kuvendit të Komunës
Data: 02.10.2023
Ora: 10.00

Prezentë në takim:

Z. Shefket Kolgeci
Z.Selman Kolgeci
Z. Flamur Bytyçi
Z. Urim Suka
Z. Kushtrim Kuçi
Znj. Elmaze Bytyqi
Znj. Bulëza Kuçi
Znj.Doruntina Zenelaj
Z.Alban Berisha
Z. Bexhet Kuçi
Z. Reshat Selimaj
Z. Lirim Qatani
Z. Aziz Bytyqi
Znj.Sanie Kuçi-
Rexhepaj
Znj.Fidaije Kukaj

Znj. Afërdita Morina
Z. Vullnet Luzhnica
Z. Xhevshet Gashi
Z.Edon Sadikaj
Znj.Saranda
Bajraktari
Znj.Mimoza Bajraktari
Znj.Festë Kabashi
Z.Dardan Berisha
Z.Bajram Basha
Znj.Mevlude Kabashi
Znj.Sheqerije Zyrapi
Znj.Laureta Tafaj
Z.Liridon Fandaj
Z.Qëndrim Elshani
Z.Herolind Limaj
Znj.Jehona Rrafshi

Të pranishëm të tjerë

Kryetari i Komunës
Media dhe qytetarë
OSCE, LMT, KDI
Znj.Habibe Bytyqi
Z.Xheladin Sadikaj

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Asamblesë Komunale z.Bexhet Kuçi,i cili propozoi këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e të hyrave e të dalurave të buxhetit të Komunës së Suharekës për vitin 2024;

Kryesuesi - e hedh në votim rendin e ditës.

19 për, 1 kundër
Miratohet rendi i ditës

Pika 1. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e të hyrave e të dalurave të buxhetit të Komunës së Suharekës për vitin 2024;

Kryesuesi - hap debatin për këtë pikë.

Urim Suka - unë e prita që kemi me pas një ditë më të vështirë se ditëve tjera mirëpo nuk e prita një sjellje të tillë të Kryesuesit që në fillimet e seancës. Ju kisha lut,si pushtet me gjithë këta numra që keni,arrogancën ta mbani për vete dhe mos ta sulmoni opozitën sepse kjo është në kundërshtim me demokracinë dhe vlerat qytetare të këtij qyteti. Unë sot dhe në emër të grupit të LDK-së e kam të pakuptueshme se pse jemi këtu për një fakt sepse sipas jush buxheti në seancën e 28 shtatorit ka kaluar. Të dashur kuvendarë,përtej çdo interesi politikë personal,përtej çdo situatë të krijuar,sot jemi në një situatë të re dhe mjaft senszitive për zhvillimin e demokracisë dhe të funksionimit normal të këtij institucioni që është institucioni kryesor në komunën tonë 28 shtatori ka me qenë një ngjarje e rëndësishme e cila ka vendos një precedentë shumë të çuditshëm për demokracinë që në gjithë këtë histori unë as nuk di,besoj as ju për një situatë të tillë. Vullneti i kuvendarëve me 28 shtator është manipuluar. Është vendosur kundër këtij vullneti që ju me vullnet të lire keni vendos për me rrëzu një buxhet që është i keq planifikuar. Kjo nuk është situatë normale. Në një situatë të tillë,unë sot kurrë nuk do të isha ulur në karrigen që është ulur Kryesuesi.Në një situatë të tillë,dorëheqja do të ishte minimum i asaj që duhet të vendoset për funksionimin demokratikë të këtij Kuvendi. Nëse kjo ngjarje sot zhvillohet,do të kemi një votim prap për buxhetin. Si është e mundur që i njëjti Kryesues që ka manipulua me votat e seancës së 28 shtatorit,do ta hedhë në votim prapë të njëjtin projekt-buxhet? Unë i bëj thirrje secilit asamblist, secilit qytetar,ta përcjell,ta dëgjoj dhe të vendos mbi bazën e vullnetit të vet,mbi bazën e interesit qytetar dhe mbi bazën e asaj pse jemi betuar. Me 28 shtator ka ndodhë një precedentë që ne nuk duhet të lejojmë të vazhdohet. Minimalisht e ftoj Kryesuesin miqësisht siq e kam ftuar në atë seancë,të jap dorëheqje,të krijohet një rrugë e re,ta zgjedhim një kryesues të ri,të thirremi në një seancë tjetër,të diskutojmë për buxhet dhe të vendosim për buxhet bashkarisht. Buxheti nuk është i këtij pushteti,buxheti është i qytetarëve. Ky pushtet e ka keq planifikuar vazhdimisht këtë buxhet. E ka keq planifikuar edhe në këtë dokument që e keni përpara dhe jo se ne s'dojmë me kalu buxhetin por sepse është keq i planifikuar. Përgjegjësia e këtij pushteti është e tmerrshme. Atij buxheti ne i kemi thënë jo në seancën e 28 shtatorit. Ky pushtet në vend se të ftonte partitë politike, të ulej,të diskutonte për vërejtjet që i kemi dhënë në atë seancë, për votën kundër që e kemi dhënë në atë seancë,të ulemi e ti bëjmë ndryshimet e nevojshme që ta bëjmë një buxhet i cili do ti binte mirë njerëzve dhe jo mirë pushtetarëve me arrogancë,pa asnjë përmirësim Na thirrë të gjithëve sikur të ishim lodra,sikur të ishim numra. Nuk na vlerëson as për njeri,nuk na vlerëson për as atë besimin që kemi marrë të njerëzve. Kërkesa ime është për të gjithë ju. Nuk mund të vazhdojmë me këtë logjikë. Duhet ti japim drejtimin e duhur kësaj Komune. Kërkesa jonë është legjitime. Dorëheqja e Kryesuesit,ndalimi i kësaj seance,thirrja e grupeve parlamentare,përmirësimi i buxhetit dhe në një seancë tjetër e diskutojmë dhe nëse pajtohemi për buxhetin,mund edhe ta votojmë.

Në mirëkuptimin e të gjithëve,të gjithë ata asambleist që mendojnë që kjo që ka ndodh është pa precedentë dhe duhet të pengohet,e ftoj secilin,pa prejashtim partie,pa prejashtim të asnjë situatë,ta lëshojnë këtë seancë e cila është e thirrur keq,e planifikuar keq dhe e cila,nëse vazhdohet do të krijoj rezultate të këqija për demokraci dhe për zhvillimin demokratik të Komunës tonë.Secili asambleist që e ndien veten për me i mbrojtë vlerat demokratike të qytetit tonë,ju lutem,pa përjashtim partie ta lëshojmë këtë seancë e cila është një marifet i kurditur që nuk duhet të vazhdoj.

Grupi parlamentar i LDK-së lëshojnë mbledhjen

Kryesuesi - pika për të cilën është thirrur seanca e jashtëzakonshme,e kemi diskutuar në seancën e datës 28. Pas diskutimeve ka ardhë në përfundim dhe e kemi hedhë në votim. Është shumë e vërtetë që në atë seancë kanë qenë 29 delegat. Në qoftëse unë jam gabim në këtë moment, ju lutem korrigjomeni. Kanë qenë 29 delegat dhe në momentin kur unë e kam hedhë në votim,është e vërtetë që kanë dalë 14 për,13 kundër dhe nuk ka pas abstenime. Në një moment unë kam dashtë me iu drejtu asambleistes, Afërditës sepse nuk e kam pa se në çfarë forme ka votu,mirëpo është e drejtë e çdo kujt që mos me marrë pjesë në votim. Ndoshta ka ndodhë një lëshim teknik,pa vetëdije sepse ky buxhet nuk është i imi,as i Kryetarit,as i AAK-së por është buxhet i Komunës dhe ndoshta ka ndodh një lëshim. Kur jam kthi në shtëpi e kam ndier pak veten të shqetësuar.I kam marrë kamerat,i kam shiku dhe i kam kërku edhe dy vota ku janë sepse unë e di që 29 kanë qenë dhe në votim kanë dalë 27. Mund të ndodhin edhe gabime teknike. Mbi dhjetë vite jam në këtë Asamble dhe ka 6 vite që e menaxhoj Kuvendin dhe kurrë s'kam pas asnjë problem. Prap po e them, edhe në qoftëse kjo ka ndodhë,gabimet ndodhin sepse njerëzit mund edhe të gabojnë por në disa raste unë shpesh ju them juve që ta ngritni dorën më lartë dhe të shoh se kush po voton për,kush kundër e kush po apstemon por ka raste edhe që nuk mund ti shoh.Mos e merrni atë gjendje që Urim Suka qohet dhe përpilon lista të natës,lista me të cilën më kthen në kohën e komunizmit kur UDB-ja ka përpilu lista për me i likfidu njerëzit natën. Ky vend nuk është vetëm i imi por është edhe i juaji.Unë prap po e them,në qoftëse del,unë kërkoj falje.Hap debatin për këtë pikë.

Saranda Bajraktari - është fakt që në seancën e kaluar vota ime ka qenë kundër për vet faktin që disa nga shqetësimet e qytetarëve nuk janë marrë parasysh dhe rekomandoj që të hyjnë në buxhet disa rrugë dhe tri kanalizime.Segment në rrugën”Kadri Qollaku” 300 m në Bllacë;rruga “Ymer Krasniqi” 120 m; rruga “Valbona” 100 m; kanalizimi 120 m në rrugën” Kumanova” në Bllacë; kanalizim 180 m në Shirokë rruga “Ndre Mjedja”; Kanalizim 300 m në rrugën”Flaka”në Baqefc.Me këto kërkesa që janë elementare dhe të nevojshme për qytetarët,vota ime është për nëse këto hyjnë në buxhet.

Liridon Fandaj - unë kërkoja të mos linqohet asnjë asambleist pa marrë parasysh prej cilës parti është. Nëse thirrja e kësaj seance të jashtëzakonshme për ri votimin e buxhetit na bën shumë të sigurtë që keqnumërimi yt ka qenë i qëllimshëm për arsye sepse dy here ta kam tërhek vërejtjen dhe të kam thënë ta hedhësh në votim.Kjo ka qenë veq,që me 30.09. me shku afat ligjor buxheti,nuk ka qenë puna e numërimit gabim.Dhe sot vjen i linqon asambleistët e opozitës.

Kryesuesi - faktikisht ne kur kemi bisedu ka qenë te pika 5.

Liridon Fandaj - po.A ka qenë i qëllimshëm? po shihet edhe sot.Sot kemi ardhë në një seancë të jashtëzakonshme me votu një buxhet të kontrabandum dhe një buxhet që sot nuk mund të ndryshohet.

Kryesuesi -deri sa jemi duke e votu këtë buxhet,çdo ndryshim mund të ndodhë.E sqaroi edhe zyrtari ligjor.

Liridon Fandaj - nëse votohet sot ky buxhet,a ndryshohet?

Kryesuesi - votohet me këtë ndryshim,pra,kërkesën e Sarandës.

Saranda Bajraktari - zyrtar ligjor këto rekomandime hyn në kuadër të buxhetit dhe a votohet me këto ndryshime?

Avni Bytyqi - çdo propozim që jepet nga ky Kuvend dhe para se të miratohet në tërësi buxheti,së pari hedhen në votim propozimet e secilit anëtar të Asamblesë dhe nëse votohen propozimet e juaja, atëherë këto propozime inkorporohen në kuadër të projekt-buxhetit dhe votohet edhe një here në tërësi buxheti si buxhet për vitin 2024.

Dardan Berisha - në dëgjimin publik që është bë,në Gjinoc kanë qenë disa propozime të cilat gjatë shkrimit janë të gabuara.P.sh. Rruga “Ragip Haziraj” ti shtohet “Ragip Haziraj” segment;Të hiqet

rruga "Tahir Zeqiraj" dhe të vendoset rruga "10 Qershori" segment (Jahir Zeqiraj); Në Studenqan - pyllëzimi i parcelës rreth gurëthyesve dhe ujë të pijshëm në lagjen e Përzhakëve.

Reshat Selimaj - Kryesues, ne e kemi pas diskutu për një rrugë të shkurtë "Rrahim Salih" por si duket ka harru drejtori dhe kërkoj të shtohet ajo rrugë.

Laureta Tafaj - Kryetar, ndoshta ish kanë ma mirë herave tjera me na thirrë dhe krejt sëbashku me propozu rrugë e kanalizime për buxhetin, se sa kështu në minutat e fundit. Pak po dalim si hajgare me këto fontatana dëshirash. Të lutem Kryetar, herën tjetër ta kesh parasys.

Jehona Rrafshi - gjatë shqyrtimit të buxhetit edhe unë kam hasë në disa pakënaqësi. Bëhet fjalë për rrugën "Studenti" në Duhël e cila është 100 metra dhe kërkoj të futet në planifikim, pastaj rruga "Tajar Atipi" 150 metra si dhe renovimi i rrugës "Rrafshi" në fshatin Duhël.

Kryesuesi - e hedh në votim propozimin e Sarandës.

**17 për, 2 apstenime
Miratohet**

Kryesuesi - e hedh në votim propozimin e Dardanit.

**15 për, 2 apstenime
Miratohet**

Kryesuesi - e hedh në votim propozimin e Jehonës.

**15 për, 2 apstenime
Miratohet**

Kryesuesi - e hedh në votim propozimin e Reshat Selimaj.

**17 për, 1 apstenime
Miratohet**

Vullnet Luzhnica - unë propozoj që te merret parasys rruga "Ismet Kodra" segment nr. 136 në Leshan dhe kërkoj nga drejtori i urbanizimit por edhe nga drejtorët në fjalë të cilët janë, ta bëjnë një studim edhe për fshatin Javor për kanalizim sepse tash e 22 vite nuk është investu as edhe një meter dhe kjo votë le të merret parash në këmbim të asaj.

Kryesuesi - e hedh në votim propozimin e Vullnet Luzhnicës.

**16 për, 2 apstenime
Miratohet**

Kryesuesi - e hedh në votim në tërësi projekt-buxhetin për vitin 2024.

**16 për, 5 kundër, 1 apstenim
Miratohet**

Takimi përfundoi: 10:33

Procesmbajtësja: Dafina Haziraj